



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:112677  
Datë: 18.12.2023  
Numri i dokumentit: 05082907

**PA1.nr.1061/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haiziri anëtar, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.Rr., nga Prishtina, për shkak të veprës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Aktivitetet e jashtëligjshme minerare nga neni 80 par.1 të Ligjit për Miniera dhe Minerale, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P.nr.158/20 të datës 18.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.Dhjetor 2023 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P.nr.158/20 të datës 18.07.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P.nr.158/20 të datës 18.07.2023, ndaj të akuzuarit N.Rr., është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale për shkak të veprave penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Aktivitetet e jashtëligjshme minerare nga neni 80 par.1 të Ligjit për Miniera dhe Minerale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Pala e dëmtuar Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare me seli në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

## **Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes se ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, apo qe te njëjtin ta ndryshoj dhe te akuzuarin ta shpallë fajtor per veprat penale per te cilat është akuzuar.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, me shkresën e vet PPA.II.nr.1097/23 të datës 31.08.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ta aprovoje si të bazuar, te anulohet aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare dhe çështja t’i kthehet Gjykatës së shkallës së parë ne rigjykim dhe vendosje apo qe te njëjtin ta ndryshoj dhe te akuzuarin ta shpallë fajtor për veprat penale për te cilat është akuzuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, për te cilën nuk i ftoi palët ngase ne rastin konkret kemi te bëjmë aktgjykim refuzues, andaj ftesa e palëve nuk është e obliguar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe gjeti se:

### **- Ankesa nuk është e bazuar.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave te procedurës penale Prokuroria Themelore në Mitrovicë me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare është i përfshire me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale ngase gjykata e shkalles se pare ne rastin konkret kur ka nxjerr aktgjykim refuzues e ka shkelur edhe ligjin penal ne favor te te akuzuarit ngase ne rastin konkret nuk ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale e sikur këto rrethana te ishin vlerësuar ne mënyre te duhur eshte dashur qe i akuzuari te shpallet fajtor per veprat penale per te cilat eshte akuzuar dhe t’i shqiptohet dënim meritor sipas ligjit me ç’rast edhe gabimisht eshte vërtetuar gjendja faktike per çka kete aktgjykim e bënë te paqëndrueshëm per çka te njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet ankimore te Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë dhe konstatoi se te njejtat nuk janë te bazuara ngase per veprat penale per te cilat eshte akuzuar N.Rr. ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale ne kuptim te dispozitës ligjore te nenit 106 par.1 nën par.1.6 e lidhur me nenin 107 par.8 të Kodit të vjetër Penal të Republikës se Kosoves, ngase i akuzuari dyshohet se veprat penale t’i ketë kryer me datë 23.10.2018 dhe që nga koha e kryerjes e deri më tani kanë kaluar më tepër se 4 vite, çka nënkupton se ne rastin konkret ka rrjedhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Për këto arsye Gjykata e Apelit e Kosovës e refuzoi si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë dhe konstatoi se ne rastin konkret ka rrjedhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale andaj pretendimet ankimore lidhur me shkeljet

esenciale te dispozitave te procedurës penale, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe shkeljes se ligjit penal ne favor të të akuzuarit i refuzoi si te pabazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1061/23 më 05.12.2023**

**Procesmbajtës**  
**Arben Arifi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit,**  
**Skender Çoçaj**

---

**Zyhdi Haziri**

---